

**AKT NORMATIV**  
**Nr. 19, datë 16.4.2021**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NËNSHKRUAR NDËRMJET  
“HUMAN VACCINE” LLC DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR  
RINDËRTIMIN TË SHQIPËRISË DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK,  
PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN KUNDËR  
COVID-19 “SPUTNIK V”, TË ZHVILLUAR NGA INSTITUTI KOMBËTAR I  
KËRKIMIT *GAMALEYA* PËR EPIDEMIOLOGJINË DHE MIKROBIOLOGJINË  
NË RUSI**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

**Miratimi i marrëveshjes së nënshkruar**

Miratimin e marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet “*Human Vaccine*” LLC dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin të Shqipërisë dhe Institutit të Shëndetit Publik, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën “Sputnik V”, të zhvilluar nga Instituti Kombëtar i Kërkimit *Gamaleya* për Epidemiologjinë dhe Mikrobiologjinë në Rusi, sipas tekstit bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2

**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**